



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Nr. 02/2 prot.

Vlorë, më 07.01.2019

Lënda: Skema e vlerësimit të kandidatëve për personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor për vitin akademik 2018-2019.

FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK

Dekanes së Fakultetit

Prof.asoc.Aurela Saliqaj

E nderuar znj. Dekane,

Në zbatim të Urdhërit të Rektorit Nr.117, pika 3, datë 24.12.2018 për " Ngritjen e komisionit ad-hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të plotë, në Fakultetin e Shëndetit Publik në Universitetin 'Ismail Qemali' Vlorë për vitin akademik 2018-2019" bazuar në Vendimin nr.07, dt.10-02-2016 të Senatit Akademik të UV, pika 7 për "Procedurën e konkurimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel akademik", si dhe në kriteret specifike të programeve mësimore të Departamentit të Kujdesit Shëndetësor, paraqitur në shkresën Nr.205/1, dt.17-12-2018), po ju përcjell skemën e vlerësimit të kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të plotë e cila përfshin rubrikat e mëposhtme:

1. Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në IAL Publike në Shqipëri
2. Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në universitetet e BE
3. Eksperienca në mësimdhënie në IAL
4. Aktiviteti shkencor
5. Studime të Ciklit III (Doktoraturë / Specializim afatgjatë / Master Ekzekutiv) në vazhdim
6. Grada shkencore dhe Tituj akademikë
7. Njohuri në Gjuhë të Huaj
8. Eksperienca profesionale
9. Intervista

Tabela përmbledhëse paraqitet bashkangjitur.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Vlerësimi me pikë për çdo rubrikë bëhet sipas kritereve të mëposhtme:

Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në IAL Publike në Shqipëri

Tipi i Diplomës	Pikët
Diploma 'Bachelor' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	0.5 pikë
Diploma '4-vjeçare' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	0.75 pikë
Diploma '5-vjeçare' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	1 pikë
Diploma 'Master i Shkencave' ose 'Master i Nivelit të Dytë' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	0.5 pikë

Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në universitetet e BE

Tipi i Diplomës	Pikët
Diploma 'Bachelor' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	0.75 pikë
Diploma '4-vjeçare' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	1 pikë
Diploma '5-vjeçare' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	1,5 pikë
Diploma 'Master i Shkencave' – për çdo 1/10 e notës mesatare në intervalin 8-10.	0.75 pikë

Eksperienca në mësimdhënie në IAL

Tipi i punësimit	Pikët
Me kohë të plotë	1 pikë për çdo vit pune, por jo më shumë se 5 pikë në total
Me kohë të pjesshme	0.5 pikë për çdo vit pune, por jo më shumë se 2 pikë në total

Aktiviteti shkencor

Botime artikujsh	Pikët
Botime në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti në Thompson Reuters	5 pikë për çdo artikull.
Botime në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial	2 pikë për çdo artikull

Studime të Ciklit III (Doktoraturë / Specializim afatgjatë / Master Ekzekutiv) në vazhdim

Provimet e dhëna në program	Pikët
Për 60 kredite të pjesës teorike	10 pikë

Grada shkencore dhe Tituj akademikë

Grada / Titulli	Pikët
Master Ekzekutiv	30 pikë
Doktor i Shkencave / Specializim afatgjatë	50 pikë
PhD në BE / Profesor i asocijuar	70 pikë
Profesor	100 pikë



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Njohuri në Gjuhë të Huaj

Niveli i gjuhës	Pikët
Anglisht – Niveli B2	2 pikë
Anglisht – Niveli C1	5 pikë
Gjermanisht – Niveli B1	2 pikë
Gjermanisht – Niveli B2	5 pikë

Eksperiencia profesionale

Vitet e punësimit	Pikët
Punësim mbi 3 vjet në BE/USA	10 pikë
Punësim mbi 3 vjet në Shqipëri si kryeinfermier	8 pikë
Punësim mbi 3 vjet në Shqipëri në shërbimin dytësor	5 pikë
Punësim mbi 3 vjet në Shqipëri në shërbimin parësor	3 pikë

Intervista

Intervistë me gojë	Pikët
Maksimumi	10 pikë

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Dr.Ela Peto